



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

R R E G U L L O R E

Nr. 01. 2016

**MBI KUSHTET DHE RREGULLAT E SHFRYTËZIMIT TË AUTOMJETEVE
ZYRTARE**

Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, mbështetur në nenin 142.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 25. të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës nr. 03/L-229 data: 07. tetor 2010, Gazeta Zyrtare nr. 88/25 nëntor 2010, dhe Ligjit nr.04/L-226 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës të dt. 13.shkurt 2014. Dhe nenit 12. Par.1.3 i Statutit të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës nr. 04-V- 312 data 24. 08. 2012 dhe me qëllim të zbatimit të vendimit të Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës nr.15/16. data 20. 06. 2016.

Miraton:

Rregullorën nr. 01/2016, Mbi Kushtet dhe Rregullat e Përdorimit të Automjeteve Zyrtare.

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet dhe mënyra e përdorimit të automjeteve zyrtare të Autoritetit Kosovarë të Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Autoriteti) të drejtadhe përgjegjësitë e të punësuarve në Autoritet lidhur me përdorimin e automjeteve zyrtare.

Neni 2

I punësuar, në kuptim të kësaj rregulloreje, do të thotë personi i cili është i punësuar në Autoritet për një periudhë të pacaktuar ose të caktuar të kohës, personi i emruar në organet e Autoritetit dhe subjektet e tjera që kryejnë punë për Autoritetin në bazë të ndonjë kontrate për punë të përkohshme, kontratë mbi vepër ose marrëdhënje tjera kontraktuale.

Neni 3

3.1. Automjet zyrtar, në kuptim të kësaj rregulloreje, do të thotë: automjeti që është blerë për Autoritetin për qëllim të transportit të personave, lidhur me kryerjen e detyrave dhe autorizimeve të Autoritetit.

3.2. Automjetet zyrtare mund të përdoren për kryerjen e detyrave në kuadër të Autoritetit edhe në raste të tjera kur është në interes të Autoritetit.

3.3. Në rast se ndonjeri nga të punësuarit nuk u bindet dispozitave të kësaj Rregulloreje AKK mbanë të drejtën e inicimit të procedurës disiplinore.

II. PËRDORIMI I AUTOMJETEVE

Neni 4.

4.1. Automjetet zyrtare përdoren për qëllime zyrtare në gjithë teritorin e Republikës së Kosovës.. Automjetet zyrtare përjashtimisht, mund të përdoren për udhëtime zyrtare edhe jashtë vendit, në bazë të autorizimit të Kryetarit të Autoritetit ose në mungesë të kryetarit Zëvendës kryetarit, ose ndonjerit nga anëtarët e komisionit të autorizur nga kryetari duke iu përmbajtur dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe Ligjeve në fuqi.

4.2. Automjetet zyrtare, si rregull, përdoren gjatë orarit të punës, dhe pas orarit të punës sipas nevojë.

4.3. Kryetari, Zëvendëskryetari, dhe anëtarët e Komisionit për qëllime zyrtare do të kenë në përdorim 24 orë automjetet zyrtare.

4.4. Sekretari dhe drejtorët mund ta përdorin automjetin zyrtarë edhe jashtë orarit të punës me lejen e Kryetarit.

4.5. Në raste të caktuara, për shkak të specifikave të posaqme të punës me lejen e Kryetarit lejohet përdorimi i automjeteve zyrtare edhe jashtë orarit zyrtarë të punës me propozim të sekretarit dhe drejtorëve.

Neni 5

5.1. Automjetet zyrtare mund të përdorin të punësuarit që kanë patentën e duhur dhe i plotësojnë kushtet e tjera të përcaktuara në Ligjin për Siguri në Komunikacion, me autorizimin nga kryetari.

5.2. Çdo i punësuar që ka të drejtë të përdorimit të automjeteve zyrtare, duhet që paraprakisht të kontrollojë automjetin dhe të sigurohet se janë të plotësuara të gjitha kushtet për të dalë në trafik.

5.3. I punësuar i cili drejton automjetin zyrtarë përgjigjet për mos respektimin e rregullave të parashikuara në dispozitat ligjore.

Neni 6

6.1. I punësuar i cili përdorë automjetin zyrtar është i detyruar që të ketë fleteudhëtimin në të cilin shënohet:

- Data,
- Emri dhe mbiemri i përdoruesit,
- Numri i ID-se
- Koha e nisjes dhe kthimit,
- Relacioni i udhëtimit,
- Kilometrazha e fillimit dhe mbarimit,
- Qellimi i udhëtimit,
- Numri i kilometrave të kaluara,
- Dhe Nenshkrimi i përdoruesve,

6.2. I punësuar i cili përdorë automjetin është i detyruar që pas kryerjes së punës zyrtare, personit të autorizuar, të dorëzojë automjetin, qelset, dhe fleteudhëtimin e plotësuar, si dhe të njoftojë për gjendjen e automjetit të përdorur i cili do të parkohet në vendin e caktuar nga Autoriteti.

Neni 7.

7.1. Kryetari, i Autoritetit ose personi që e autorizon kryetari lejon shfrytëzimin e automjetit zyrtarë bazuar në kërkesën që parashtron i punësuar.

7.2. Të gjithë të punësuarit në kuadër të detyrave të punës janë të detyruar që të bëjnë planifikimin dhe me kohë të parashtronjë kërkesë për shfrytëzimin e automjetit.

Neni 8.

8.1. Zyrtari i cili e autorizon Kryetari në kuadër të detyrave të punës angazhohet për shfrytëzimin racional dhe ekonomik të automjeteve zyrtare dhe në kuadër të kësaj ndërmerr masat e nevojshme për kontrollimet teknike të rregullta e të jashtëzakonshme dhe regjistrimin e tyre si dhe mbajtjen e evidencës së riparimeve eventuale.

8.2. Zyrtari i autorizuar percjelle dhe kontrollon evidencen e përdorimit te automjeteve zyrtare e që përmban:

- Tipin e automjetit,
- Numrin e regjistrimit,
- Kilometrat e kaluara ne funde te gjdo muaji kalendarik,
- Sasin e shpenzuar te karburantit, brenda muajit,
- Shpenzimin mesatar ne 100 Kilometra.
-

8.3. Te gjithë përdoruesit e automjeteve jane te detyruar qe zyrtarit te autorizuar t’ia paraqesin faturen per derivatet e shpenzuara me qellim te mbajtjes se evidences.

III. SHFRYTEZIMI I AUTO TAKSIVE

Neni 9.

9.1. Nese te gjitha automjetet jane ne perdorim apo per gjdo arsye tjeter nuk munde te perdoren, AKK munde te lejoj shfrytezimin e auto taksive per kryerjen e puneve zyrtare kur paraqiten nevoja urgjente.

9.2. Përdoruesi i auto taksive eshte i detyruar qe ta marre kuponin fiskal per shpenzimet e bera, te cilin do ta vertetoi zyrtari i autorizuar.

Neni 10

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe nënshkrimit nga Komisioni i AKK-së.

Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës

Valon Prestreshi, kryetar _____

Ahmet Krasniqi, zëvendëskryetar _____

Fatime Haziri, anëtar _____

Muhamet Krasniqi, anëtar _____

Shaqir Morina, anëtar _____

Prishtinë data _____ 2016